

NJOFTIM
Nr. 8915, datë 4.7.2025

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
INSTITUTIT TË PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË, TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, kapitulli III, shpallen për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Brandi	12.4.2014	Tiranë	10,000	30.7.2025	10:00	DSHPP
2	Qeni Sindi	15.11.2015	Tiranë	10,000	30.7.2025	10:15	DSHPP
3	Qeni Liza	1.11.2014	Tiranë	10,000	30.7.2025	10:30	DSHPP
4	Qeni Vreni	28.9.2018	Tiranë	10,000	30.7.2025	10:45	DSHPP
5	Qeni Mega	12.11.2014	Tiranë	10,000	30.7.2025	11:00	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Garancinë bankare apo mandatpagesën në origjinal, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

3. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, pasi të kenë tërhequr pranë DSHPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim, të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: www.meki.gov.al.